69.	Hadije Rushiti	/	

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

Ekonomi, biznes , menaxhment			
70.	Blerim Imeri	IV-5	
71.	Rafije Maksuti	/	
72.	Luljeta Selami	IV-10	
Fillet e së drejtës			
73.	Fatime Kamberi (Jeton Kamberi)	/	
Art figurativ			
74.	Enver Selimi	II-3	
75.	Halime Adili	II-10	
Art muzikor			
76.	Bekim Ramadani	/	
77.	Emira Islami	/	
Sport dhe aktivitete sportive			
78.	Agon Alili	/	
79.	?	/	
80.	Fekri Sali	/	
81.	Fatmir Memeti	/	
82.	Mensur Pajaziti	/	
83.	Florim Asani	IV-12	
PARALELET ME MËSIM NË GJUHËN MAQEDONE			
84.	*Katerina Naumovska*	/	
85.	*Biljana Vasilevska*	*I-3m*	
86.	*Marko Rafajlovski*	*IV-2m*	
87.	*Marija Kovaçeviç*	*III-3m*	
88.	*Jasminka Anançevska*	*I-1m*	
89.	*Juliana Lazovska*	*IV-1m*	
90.	*Lidija Ivanovska*	*III-1m*	
91.	*Jugica Teofillovska*	*II-1m*	
92.	*Suzana Stankovska*	/	
93.	*Igor Petkovski*	/	
94.	*Natasha Qirovska*	*IV-3m*	
95.	*Jasmina Kirovska*	/	
96.	*Lepa Vasilevska*	*II-3m*	
97.	*Marijana Koçevska*	/	
98.	*Tatjana Nikollovska*	/	
99.	*Nena Rafajllovska*	/	
100.	*Katerina Filipovska*	/	
101.	*Hristina Kostovska*	/	
102.	*Filip Pavllovski*	/	

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

SHPËRNDARJA E ORËVE PËR KUADRIN ARSIMOR PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

1. Gjuhë shqipe dhe letërsi

	Emridhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	**Gjithsej**
1.	*Ylbere Neziri*	20	II-6	21
2.	*Teuta Llalla*	20	/	20
3.	*Lindita Emurllahu*	20	/	20
4.	*Daut Arifi*	20	III-5	21
5.	*Hashim Baftijari*	20	/	20
6.	*Arjeta Osmani Shabani*	12	III-12	21
7.	*Xhemal Skenderi*	20	IV-1	21
8.	*Florina Ismaili*	20	IV-6	21
9.	*Fexhide Zeqiri*	20	/	20
10.	*Vjollca Baftijari*	20	I-5	20
	Gjithsej	**192**	**6**	

2. Gjuhë maqedone

	Emridhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	**Gjithsej**
1.	*Nadica? (Aneta Acoska)*	20	III-2m	
2.	*Sonja Jovçevska*	20	I-2m	
3.	*Zorica Bojçeve*	20	/	
4.	*Goran Isakoski*	20	/	
5.	*Magdalena Petrovska*	20	/	
6.	*Milena Laziç*	20	/	
7.	*Brankica Ristoska*	20	II-2	
	Gjithsej	**140**	**1**	

3. Gjuhë angleze

	Emridhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Lirije Zeqiri*	18	II-4	
2.	*Lulzime Xhelili*	18	II-7	
3.	*Safet Neziri*	18	III-2	
4.	*Erza Ameti (Hatije Etemi)*	18	III-7	
5.	*Melihate Etemi*	18	/	
6.	*Ajser Sadiki*	18	IV-7	
7.	*Jetmire Misimi*	18	I-2	
8.	*Kimete Memedi*	18	/	
	Gjithsej	**192**	**6**	

4. Gjuhë frenge

	Emri dhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Majlinda Sinani*		II-12	
	Gjithsej		**1**	

5. Gjuhë gjermane

	Emri dhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Blerta Idrizi*		/	
2.	*Ilmije Jashari*		III-6	
3.	*Zana Iljazi*		IV-9	
4.	*Burhan Asani*		I-6	
	Gjithsej	**95**	**3**	**98**

6. Gjuhë latine

	Emri dhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Besa Saliu*		III-3	
	Gjithsej		**1**	

7. Matematikë, analizë matematikore, algjebër, algjelbër lineare dhe gjeometri

	Emri dhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Merjem Rakipi (Imer Islami)*		II-5	
2.	*Flora Rustemi*		II-8	
3.	*Bajram Shaini*		III-1	
4.	*Isa Rexhepi*		III-8	
5.	*Islam Haliti*		IV-2	
6.	*Liridona Memedi*		IV-11	
7.	*Arife Shaini*		I-1	
8.	*Sibajete Abduramani*		I-12	
9.	*Sejhan Idrizi*		IV-3	
	Gjithsej		**9**	

8. Fizikë

	Emri dhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Anila Demiri*		II-1	
2.	*Raman Etemi*		/	
3.	*Ilvije Jashari*		/	
4.	*Isak Aliu*		/	
	Gjithsej		**1**	

9. Kimi

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Flutra Alili*		I-8	
2.	*Hyden Jakupi*		I-11	
3.	*Xhevrije Abdija*		III-10	
4.	*Emira Aliu*		I-4	
	Gjithsej		**4**	

10. Biologji

	Emridhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Gajur Etemi*		/	
2.	*Sherife Alili*		III-4	
3.	*Merita Aliu*		/	
4.	*Mevlane Kamberi*		/	
	Gjithsej	**99**	**1**	**104**

11. Histori

	Emridhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Gazmend Arifi*		/	
2.	*Dashmir Shabani*		/	
3.	*Mirzana Ameti*		IV-8	
4.	*Ejup Ramadani*		I-9	
5.	*?*		/	
	Gjithsej	**124**	**2**	**128**

12. Gjeografi

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Musa Ceka*		I-7	
2.	*Nijagara Xhemaili*		II-11	
3.	*Vjosa Zulbeari (Nazif Shabani)*		/	
	Gjithsej		**2**	

13. Informatikë , teknologjia e informatikës, gjuhë programore

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Gëzime Sherifi*		II-2	
2.	*Elita Asani*		/	
3.	*Zedi Fejzullahi*		I-3	
4.	*Lisjeta Haliti*		II-9	
	Gjithsej		**3**	

14. Sociologji

	Emri dhe mbiemri	Orë +projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Arjeta Ademi*	20	/	**21**
2.	*Ajser Misimi*	20	III-11	**21**
	Gjithsej	**40**	**1**	**42**

15. Filozofi

16. Logjikë

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Sheval Latifi*	18	IV-4	**19**
2.	*Jusuf Durmishi*	18	/	**18**
3	*Hadije Rushiti Limani*	14	/	**15**
	Gjithsej	**50**	**1**	**52**

17. Ekonomi

18. Menaxhment

19. Biznes dhe afarizëm

	Emri dhe mbiemri	Orë +projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Blerim Imeri*	21	IV-5	**22**
2.	*Rafije Maksuti*	20	/	**20**
3.	*Luljeta Selami (Ilire Dauti)*	20	IV-10	
	Gjithsej		**2**	

20. HYRJE NË DREJTËSI – ORË

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Fatime Kamberi (Jaton Kamberi)*	16	/	**16**
	Gjithsej	**16**		**16**

21. ART FIGURATIV–48 ORË

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Enver Selimi*	18	II-3	**19**
2.	*Halime Adili*	18	II-10	**19**
	Gjithsej	**36**	2	**38**

22. ART MUZIKOR – ORË

	Emri dhe mbiemri	Orë+projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Bekim Ramadani*	18	/	**18**
2.	*Emira Islami*	18	/	**18**
	Gjithsej	**36**		**36**

23. SPORT DHE AKTIVITETE SPORTIVE – 120 ORË

	Emri dhe mbiemri	Orë + projekte	Kujdestar klase	Gjithsej
1.	*Agon Alili*	20	/	**20**
2.	*?*	20	/	**20**
3.	*Fekri Sali*	20	/	**20**
4.	*Fatmir Memeti*	20	/	**21**
5.	*Mensur Pajaziti*	20	/	**20**
6.	*Florim Asani*	20	IV-12	**21**
	Gjithsej	**120**	**1**	**122**

KUADRI UDHËHEQËS, AI NDIHMËS DHE KUADRI TEKNIKO- ADMINISTRATIV

Në SHMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"–Tetovë, sipas Rregullores për organizimin dhe sistemimin e të punësuarve në marrëdhënie pune janë:

Drejtori, tre udhëheqës në ndërrime të angazhuar me nga 10 orë, një pedagog, një psikolog, një bibliotekist, sekretar, arkëtar- administrator, një hausmjeshtër për të dy ndërrimet, dy roje nate dhe 9 punëtor tekik.

	Emridhe mbiemri	**Vendi i punës**
1	***Jeton Kamberi***	Drejtor
2	***Nazif Shabani***	Udhëheqës ndërrimi
3	***Imer Islami***	Udhëheqës ndërrimi
4	***Aneta Acoska***	Udhëheqës ndërrimi (paralelet maqedonase)
5	***Suzaa Jonuzi***	Psikolog
6	***Hasrit Abdullahu***	Pedagog
7	***Isen Murati***	Bibliotekist
8	***Sami Vehapi***	Këshilltarë për çështje juridike-Sekretar
9	***Mustaf Jonuzi***	Këshilltarë për financa -llogaritar
10	***Besime Abduramani***	Arkëtarë
11	***Shpëtim Fetai***	Hausmajstor
12	***Efraim Deari***	Roje nate
13	***Drini Shtrezi***	Roje nate
14	***Memet Sali***	Punëtor teknik
15	***Memet Abdullahu***	Punëtor teknik
16	***Servet Elmazi***	Punëtor teknik
17	***Billall Zilbeari***	Punëtor teknik
18	***Fadil Schrank***	Punëtor teknik
19	***Emine Zilbeari***	Punëtor teknik
20	***Ermira Rakipi***	Punëtor teknik
21	***Haxhere Sulejmani***	Punëtor teknik
22	***Evica Ristovska***	Punëtor teknik
23	***Verica Jaqimovska***	Punëtor teknik

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

Mësimi zgjedhor

Lëndët zgjedhore janë të përfaqësuar në arsimimin e gjimnazit dhe arsimit profesional. Nëpërmjet programit zgjedhor nxënësit i zgjerojnë dhe thellojnë dituritë, aftësitë dhe shkathtësitë nga lëmit shkencore për të cilën janë përcaktuar. Gjerësia e programeve zgjedhore gradualisht zgjerohet prej vitit të dytë deri në vitin e katërt.
Programet zgjedhore janë në funksion të orientimit profesional të nxënësve dhe përgatitja e tyre për përcjellje më kualitative në një shkallë më të lartë të arsimimit.

Nxënësit e viteve të para dhe prindërit e tyre, në fillim të vitit shkollorë u informuan me Planin arsimorë, përkatësisht lëndët mësimore që do ti mësojnë në vitin në rrjedhë, id dhe me listën e lëndëve zgjedhore. Në takimet prindore, prindërit edhe një herë përkujtohen për listën e lëndëve zgjedhore. Nxënësit në muajin prill anketohen dhe për një lëndë nga lista. Në mënyrën e njëjtë realizohet edhe zgjedhja e fushës dhe kombinimi me nxënësit e vitit të dytë.

Mësimi plotësues

Për nxënësit të cilët kanë vështirësi në mësim gjatë vitit shkollor do të organizohet mësim plotësues. Nga ato lëndë në të cilët do të evidentohen më shumë nota negative arsimtarët lëndor obligohen që të realizojnë mësim plotësues. Deri më 20 shtatorë do të përcaktohet orari për mësimin plotësues që do të jetë pjesë përbërëse e programit vjetor.

Mësimi shtues

Për nxënësit të cilët do të tregojnë interes të zmadhuar për përmbajtje të veçanta mësimore dhe shkencore do të organizohet mësim shtesë nëpërmjet të cilit do të sigurohet zgjerimi dhe thellimi i përmbajtjeve të lëndëve të caktuar dhe lëmive dhe pjesëmarrje të nxënësve në gara.

Çdo arsimtarë do të përpiloj programin e tij për mësimin shtesë.

Mësimi vazhdues

Për nxënësit të cilët janë dërguar në riprovim pas mbarimit të vitit shkollor do të organizohet mësim vazhdues.
Për nxënësit që janë të udhëzuar në provimin korrigjues, në pajtim me Kalendarin e punës, pas përfundimit të vitit arsimorë do të realizohet mësimi i vazhduar.

Programe të individualizuara për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore

Është përpiluar programi për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore në të cilin janë të përfshira qëllimet, përmbajtja, realizuesit dhe koha e realizimit.

Bashkimi i programit ekologjik me mësimin e rregullt

Ekostandardet ose standardet për zhvillim të qëndrueshëm janë drejtues të institucionit tonë arsimorë gjatë krijimit të policës për ngritje të vetëdijes ekologjike të nxënësve, të punësuarve dhe më gjerë.

Këto standarde përmbajnë qëllime të qarta që rezultojnë me rezultate konkrete. Me realizimin e pikave të përcaktuara të aksionit nga eko standardet, mund të realizojmë edhe ndryshime konkrete në ambientin rrethues, dhe të cilat shkaktojnë kursime financiare.

Edhe në vitin shkollorë 2026-2027 do të implementohen nëntë temat me përmbajtje ekologjike si bazë për bashkimin e praktikës me teorinë dhe afrimin e përmbajtjeve ekologjike dhe problemeve ekologjike deri te nxënësit.

Në suaza të programeve arsimore dhe përmbajtjeve arsimore, arsimtarët i bashkuan temat ekologjike – me përmbajtjet e programeve të tyre mësimore.

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

Shfrytëzimi i TIK në procesin mësimor

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së procesit mësimorë dhe zbatimit të TIK në realizimin e përmbajtjeve arsimore do të furnizohen dy klasa multimediale ku arsimtarët me orar prej më parë të përpiluar javorë, do të realizojnë procesin mësimorë. Gjithashtu të gjitha klasat do të furnizohen me LCD projektorë.

VLERËSIMI

Lëndë për përcjellje, verifikim dhe vlerësim të veprimtarisë edukativo- arsimore do të jenë rezultatet e arritura në ngadhënjimin e përmbajtjeve edukativo-arsimore, shprehitë punuese, shkallë të interesimit dhe angazhimit në mësim dhe aftësimi praktik për aplikim të diturive.

Arritje të nxënësve që të vlerësohet me aplikim të strategjive të ndryshme të vlerësimit.
Notimi duhet të jetë shprehje e orvatjevetë nxënësve gjatë orës mësimore si dhe jashtë orëve. Për këtë qëllim, mënyrat e notimit duhet të jenë të llojllojshme edhe atë:

- Vlerësimi gojarisht (që bazohet mbi standardet e vlerësimit dheTaksonomisë së Bllumit)
- Vlerësimi meshkrim (përmes testeve objektive)
- Vlerësimi formativ (gjatë vetë orës mësimore)
- Vlerësimi sumativ (në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit)

VLERËSIMI GOJARISHT: Përcaktimi notës numerike që duhet të përfshijë arritjet e nxënësit krahas të mbajturit mend dhe reproduktimit të përmbajtjeve mësimore, kuptimit dhe përvetësimit të përmbajtjeve mësimore, përkatësisht aftësive të nxënësit për interpretim të tyre me fjalë të veta, zbatimi i përmbajtjeve mësimore në detyrat konkrete me elemente të njohura dhe elemente të njohura, si dhe aftësi më të larta intelektuale për analizë, sinteza dhe vlerësimi, që nënkupton aftësinë e nxënësit për rregullim, kombinim të elementeve në tërësi të reja dhe aftësi të nxënësit për vlerësim të arsyeshëm së ndonjë konstatimi ose vepre.

Nota numerike përcaktohet në këtë mënyrë:
Nota e mjaftueshme dy (2) – dituritë nxënësve kanë të bëjnë me të mbajturin në mend dhe reproduktimin, nxënësi duhet të njoh dituritë të ofruara, të definoj, të reproduktorë fakte, të numëroj, të emëroj nocione dhe të zbatoj dituri në detyra më të thjeshta.
Nota mirë tre (3)– njohuritë e nxënësit sillet për kuptimin dhe mendimin, nxënësi është i plotësuar në kryerjen e aktiviteteve gjatë orëve, është i aftë për të interpretuar fakte, të krahasojë dhe të numërojë, të njohë termet dhe faktet dhe ti praktikoj njohuritë detyra ntë thjeshta.
Nota shumë mirë katër (4) – dituritë e nxënësve kanë të bëjnë me detyrat elementeve të njohura dhe të reja, nxënësi mund të analizoj fakte dhe praktikisht ti zbatoj dituritë, logjikisht të mendoj dhe të ketë mendimin e tij, vazhdimisht të jetë aktiv, të jetë i plotësueshëm, i rregullt në mësime dhe obligime, të interpretoj, të krahasoj dhe ti analizoj dhe ilustroj me shembuj kritik të diturive të përvetësuara.
Nota shkëlqyeshëm pesë (5) – dituritë e nxënësit kanë të bëjnë me analizë, sintezë dhe vlerësim, nxënësi mund të zbatoj dituritë për zgjidhjen e detyrave me elemente të njohura, është i aftë për mendim logjik dhe zbatim praktik të fakteve, ai ka qëndrime të ndërtuara, është i aftë të sistematizoj dhe gjeneralizojë, të hulumtoj dhe zbatoj dituritë, është i aftë për lidhjen e teorisë me praktikën, shfrytëzon burime plotësuese, parashtron dhe përgjigjet në pyetje të temave të ndryshme.

VLERËSIMI ME SHKRIM

Pas çdo tërësie tematike, verifikohet niveli i diturive përmes testeve objektive (pyetje nga 4 nivelet sipas Taksonomisë së Bllumit, pyetje me rrethim, plotësim, me bashkim, me sqarime, me zgjidhje etj.). Për këtë qëllim, fitimi i pikave është në mënyrën vijuese: prej 30% deri më 50% suksesi i realizmit të testit pason nota dy (2), prej 50% derimë 70% pason nota tre (3), prej 70% deri 85% nota katër (4) dhe prej 85% deri 100% nota pesë (5).

VLERËSIM FORMATIV

Është një proces që realizohet në vetë orët mësimore, përmes të cilave nxënësit dhe arsimtarët shqyrtojnë shkallën e përvetësimit të materies, problemeve me të cilat ballafaqohen, çfarë duhet të ndryshohet dhe ku duhet të fokusohen më të tepër përpërvetësim më të suksesshëm të materialit mësimorë.

VLERËSIMI SUMATIV

Pason si rezultat i të gjitha formave të lartpërmendura të notimit dhe realizohet në fund të gjysmë vjetorit dhe në fund të vitit shkollorë.

Ekipi për përcjellje, analizë dhe përkrahje

Në shkollë është formuar ekipi për përcjellje dhe kontrollim të harmonizimit të vlerësimit me standardet e parapara. Ekipi do ta përcaktoj procedurën për ankesa dhe parashtresa në pajtim me rregulloren për vlerësim dhe avancim të nxënësve, do të bëj analizatë gjendjes së rezultateve të arritura dhe do të jap përkrahje për arsimtarët që tregojnë suksese të dobëta në punë. Ekipi është në përbërje vijuese: Hastrit Abdullahu, Bajram Sahaini, Isak Aliu, Imer Islami, Ylbere Neziri, Burhan Asani, Sherife Husmani, Ejup Ramadani, Safet Neziri.

Vetë evalvimi i shkollës

Në çdo dy vite do të realizohet vetë evalvimi, për këtë qëllim do të formohen 7 ekipe me të cilët me metoda përkatëse dhe instrumente do të tubohen dhe shqyrtohen të dhënat me qëllim të analizës së shtatë fushave.

Aktivitete jashtëmësimore

Sporti shkollor

Në shkollën, nxënësve iu ofrohen këto sporte shkollore: basketboll, hendboll, futboll, volejboll, badminton, karate, ping – pong dhe atletikë. Arsimtarët përgjegjës do të përpilojnë programe të punës, do ti përgatisin nxënësit për gara sportive, turne, evenimente të ngjashme.

Seksione dhe aktivitete të lira të nxënësve

Nxënësit do të kenë rastin që të përcaktohen për seksionet e nxënësve sipas interesit dhe nevojave të tyre. Arsimtarët do të përpilojnë programe për këto seksione të lira:

1. SEKSIONI LETRAR
2. SEKSIONI DRAMATIK DHE RECITUES
3. SEKSIONI I EKOLOGJISË
4. SEKSIONI HISTORIK
5. SEKSIONI I GJEOGRAFISË
6. SEKSIONI I INFORMATIKËS
7. SEKSIONI I ARTIT FIGURATIV
8. SEKSIONI MUZIKOR
9. SEKSIONI I ORGANIZATAVE HUMANITARE
10. SEKSIONI PËR GJUHËTË E HUAJA
11. SEKSIONI MATEMATIKOR
12. SEKSIONI I FIZICIENTËVE TË RINJË
13. SEKSIONI I BIOLOGËVE TË RINJË
14. SEKSIONI I KIMISTËVE TË RINJË
15. AKTIVITETE TË LIRA SPORTIVE

Garat e nxënësve

Gjatë vitit shkollorë në suaza të mësimit shtesë, arsimtarët i përgatisin nxënësit e interesuar për pjesëmarrje në garat komunale, rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare. Shkolla do ti organizoj të gjitha garat shkollore të parapara në programet e aktiveve profesional.

Ekopatrullat

Në shkollë gjatë vitit shkollor, duke filluar nga muaji tetor formohen eko patrullat. Eko patrullat janë të organizuara në dy ndërrime dhe përbëhen prej dy nxënësve që janë të vitevetë ndryshme. Nxënësit gjatë kohës së procesit mësimorë patrullojnë nëpër ndërtesën e shkollës dhe në listat e përpiluara enkas për këtë qëllim drejtojnë evidencën lidhur me higjienën në shkollë. Ata kanë për detyrë në raste të vërejtjes së parregullsive, mungesës së higjienës, shporta të mbushura, konsumim të duhanit në nevojtore etj., të gjitha këto ti evidentojnë në eko fletët, që më pas në fund të ndërrimit ti dorëzojnë te ndihmës drejtori, përkatësisht te udhëheqësi ndërrimit. Nxënësit që patrullojnë janë të veshur me jelek tëgjelbër, që të dallohen nga nxënësit tjerë.

Përkrahja e nxënësve - Arritjet e nxënësve

Gjatë vitit shkollorë përcillen arritjet e nxënësve, rregullsia dhe sjellja e tyre. Bëhen analizapër suksesin për lëndët e caktuara nëtë cilët nxënësit arrijnë rezultate më të dobëta, ku organizohet mësimi plotësues. Identifikohen nxënësit me vështirësi gjatë mësimit dhe me të njëjtit, shërbimi profesional realizon biseda këshillëdhënëse, i udhëzon në teknikat efikase të mësimit dhe ndërtimit të shprehive të punës. Gjithashtu identifikohen edhe nxënësit e talentuar të cilët përmes mësimit shtesë i zgjerojnë dhe thellojnë dituritë e tyre që të marrin pjesë në gara. Nxënësve u mundësohet që aktivitetet e tyre ti prezantojnë para opinionit të gjerë si dhe të marrin pjesë në gara. Nxënësve u mundësohet që aktivitetet e tyre ti prezantojnë para opinionit të gjerë si p.sh.: projekte dramatike, pjesëmarrje në emisionet televizive, ekspozita, projekte etj.

Për nxënësit e viteve përfundimtare organizohen forma të ndryshme të orientimit profesional.

Programi preventiv kundër dhunës

Qëllimi i këtij programi është pengimi i sjelljes së dhunshme në shkollë dhe edukimi i nxënësve për zgjidhje të pa dhunshme të konflikteve.

Programi parandalues kundër sëmundjeve të varësive

Qëllimi i këtij programi është zvogëlimi i keqpërdorimit të mjeteve narkotike dhe edukimit të nxënësve përmes përmbajtjeve nga lëndët mësimore për dëmet e keqpërdorimi të këtyre mjeteve. Përmes inkuadrimit në aktivitete dhe projekte të ndryshme, nxënësit i ndërtojnë dhe preferojë stilet e shëndosha të jetës.

Shkolla do të bashkëpunojnë me Qendrën për punë sociale, MPB – seksionin për delikuencë të adoleshentëve dhe organizatat joqeveritare, me qëllim të ofrimit të ndihmës për nxënësit që manifestojnë sjellje asociale. Këta nxënës do të inkuadrohen në projekte dhe aktivitete të ndryshme.

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

Siguria në shkollë

Të gjitha subjektet e inkuadruara në procesin edukativo arsimorë në shkollë duhet të ndjehen të sigurt që të munden me sukses të realizojnë punën e tyre.

Edhe prindërit duan që fëmijë e tyre shkollën ta përjetojnë si një ambient të sigurt dhe të ndjehen këndshëm. Për këtë qëllim në shkollë ekziston video mbikëqyrje, ekziston edhe kujdesi për sigurinë fizike të nxënësve nga ana e arsimtarëve kujdestarë.

Klima pozitive socio–emocionale

Projekti "SHKOLLA TË SIGURTA –AMBIENTE TË HARMONIZUARA"

Detyra: Ndërtimi i sigurisë në shkollat përmes organizimit, krijimit dhe implementimit të aktiviteteve për ngritje të vetëdijes, aktivitete dhe qëllime të fokusuara drejtë zvogëlimit të nivelit të dhunës dhe sjelljes asociale të rinisë.

Grupi i punës

- krijimi, zhvillimi de implementimi i masave dhe aktiviteteve për identifikim të problemeve;
- Zhvillimi i aktiviteteve / planeve aksionare që do të dizajnohen për ballafaqim përmes identifikimit të problemeve specifike të sigurisë;
- Zhvillimi i strategjive të parandalimit, identifikimi dhe ballafaqimime problemet e të sigurisë në shkollë (ndeshje ndëretnike, shkrimi igrafiteve në muret e shkollës, droga, frikësimi, shkatërrimi i mobileve etj).

Aktivitetet do të jenë:

- Zhvillimi dhe implementimi i raporteve multikulturore
- Projekte që kanë të bëjnë me kulturën civile
- Kultura urbane
- Organizimi i edukimit të moshatarëve
- Fushata që do të promovojnë vlerat pozitive mes rinisë përkundër sjelljes asociale dhe të dhunshme
- Pjesëmarrje në evenimente publike të organizuar me ndihmë të OSBE,OJQ komunale dhe MPB
- Festivali muzikor rinor komunal
- Tubime publike kundër dhunës me moton "Së bashku kundër dhunës"
- Implementimi dhe aktivizimi i aktiviteteve të theksuara në dokumentin "Udhëzime strategjike për sigurinë e shkollave", pas lejimit të tij nga ana e Komunës.
- Implementimi i ekipeve shkollore për siguri 1 nxënës + 1 prind +1 profesor prej çdo gjenerata + pedagogu + nëpunësi i shërbimit policor = 15 persona
- Pjesëmarrje në hulumtime, anketime dhe analiza të rezultateve
- Implementimi dhe promovimi i kodit të sjelljes

Pas përfundimit të hulumtimit dhe analizës dhe pas përpilimit të kodit të sjelljes, do të përpilohet plani vjetor i shkollës për siguri – do të sigurohen zgjidhjet për problemet e identifikuara nga fusha e sigurisë së shkollave deri në fund të vitit.

Në shkollë do të realizohen aksione dhe fushata në pajtim me aktivitetet e parapara në planin e aktiviteteve dhe vazhdimisht sipas nevojave të shkollës dhe ambientit.

Viti shkollor 2026/2027

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

KUJDESI PËR SHËNDETIN - Higjiena në shkollë

Kujdesi i posaçëm do ti kushtohet mirëmbajtës së higjienës në shkollë. Rregullisht do të pastrohen hapësirat shkollore dhe oborri i shkollës, do të organizohen edhe aksione në të cilat do të inkuadrohen nxënësit me qëllim të ngritjes së vetëdijes së nxënësve kujdesin ndaj vetes dhe rrethit.

Kontrollimet sistematike

Të gjithë nxënësit e vitit të parë dhe të viteve përfundimtare do të përfshihen në kontrollimet sistematike që do të realizohen me marrëveshje me mjekun e dispanzerit shkollorë. Nxënësit do të përcillen nga kujdestarët e klasës ose personi i shërbimit profesional.

Vaksinimi

Me kalendarin për imunizim dhe vaksinimi do të realizohet për të gjithë nxënësit eviteve përfundimtare. Vaksinimi do të realizohet në Dispanzerit shkollorë, kurse nxënësit do të përcillen nga kujdestari i klasës.

Edukimi për ushqim të shëndoshë

Në suaza të orëve të kujdestarisë dhe gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore, nxënësit do të njoftohen me mënyrat e ushqimit të shëndoshë. Gjithashtu në mënyrë aktive do të marrin pjesë në fushatën "Ushqimi i shëndoshë për fëmijët pa të meta" me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe përgjegjësive për shëndetin e tyre, duhet shënuar me këtë ditën ndërkombëtare të ushqimit – 16 tetorin.

Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

Disiplina

Me qëllim të përmirësimit të disiplinës shkollore do të inkuadrohen të gjithë subjektet në shkollë dhe prindërit. Në kohë do të ndërmerren masat konkrete (identifikimi i nxënësve që cenojnë disiplinën, biseda këshillëdhënëse me të njëjtit, inkuadrimi i prindërve, kujdestarit e arsimtarëve). Për kujdestaritë e arsimtarëve do të përpilohet edhe orari. Në librin e kujdestarive do të mbahet evidenca për ndodhitë rrjedhëse.

Rregullimi estetik dhe funksional i hapësirës në shkollë

Në më shumë segmente të punës edukativo arsimore mbahet llogari për rregullimin estetik dhe mirëmbajtjen e hapësirës në shkollë. Gjatë kësaj janë të inkuadruar të gjithë subjektet në shkollë, në veçanti nxënësit me qëllim të zhvillimit të multi kulturalizmit dhe ngritjes së vetëdijes për ruajtje të ambientit.

Multi-kulturalizmit

Mbahet llogari për realizimin e të gjithë aktiviteteve ku do të përfshihen nxënësit e të gjuha grupeve etnike, me qëllim të njoftimit të tyre, njoftimit dhe respektimit të diversiteteve.

Raportet në mes të gjitha strukturave

Mbahet llogari për përmirësimin e komunikimit të ndërsjellë në mes të punësuarve dhe nxënësve. Përskaj trajnimeve të realizuara për përmirësim të aftësive të komunikimit organizohen edhe shoqërime të përbashkëta, manifestimeve, ekskursioneve koktejeve.

Kodi etik

Në shkollën tonë është përpiluar eko kodi përmes të cilit definohet i tërë misioni i shkollës. Përmes kodit etik që është theksuar në vend të dukshëm, dëshmohet përkushtimi i shkollës për përmirësim të kushteve në të cilat mësohet dhe punohet.

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

Zhvillimi profesional i kuadrit mësimorë

Detektimi i nevojave dhe prioriteteve

Një prej prioriteteve që pasojnë nga gjendjet e detektuara nga vetë evalvimi është nevoja për zhvillim profesional të arsimtarëve.

Aktivitete për zhvillim profesional

Në planin zhvillimorë të shkollës, një prej qëllimeve zhvillimore është edhe përsosja profesionale e arsimtarëve. Shtojca – tabela e planit zhvillimorë.

Zhvillimi personal profesional

Çdo arsimtarë në mënyrë individuale dhe kolektive, profesionalisht përsoset. Individualisht përmes përcjelljes së literaturës profesionale dhe kolektivisht përmes seminareve dhe trajnimeve. Për zhvillimin e tij profesional drejtohet portofoli.
Planifikohet pjesëmarrja aktive e arsimtarëve dhe të punësuarve në trajnimet e ofruara nga programi i ekologjisë.

Aktivët profesionale rregullisht mbajnë takime në të cilat diskutojnë dhe shkëmbejnë përvoja dhe mendime. Gjithashtu vizitojnë realizojnë vizita të ndërsjella. Përskaj shkëmbimit të përvojave profesionale, bashkëpunimit ekiporë, shumë i rëndësishëm është edhe zhvillimi produktiv për komunikim të hapur, respektimi dhe besimi i ndërsjellë, zgjidhja konstruktive e situatave problematike.

Inkuadrimi i familjes në shkollë

Prindërit përmes Këshillit të prindërve dhe anëtarëve nga radhët e Këshillit të shkollës, që janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjitha segmentet e jetës dhe punës në shkollë.

Këshilli i prindërve pranë SHMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq" i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me jetën dhe punën në shkollë, suksesin, sjelljen dhe rregullsinë e nxënësve si dhe jep mendime për përmirësimin e tyre.

Mes tjerave, Këshilli i prindërve, kujdeset edhe për sigurimin e mjeteve monetare dhe materiale përmes llojeve të ndryshme të sponsorisimeve, për modernizim të procesit mësimorë dhe realizimin e ekskursioneve, shpërblimin e nxënësve, përkatësisht për përmirësimin e përgjithshëm të kushteve të punës.

Këshilli i prindërve kujdeset për sigurimin e mjeteve për nxënësit që janë me probleme sociale si dhe për punë të tjera që janë në interes për shkollën dhe për nxënësit.

1. Shqyrtimi i suksesit, sjelljes dhe rregullsisë së nxënësve.

Suksesi, sjellja de rregullsia e nxënësve do të shqyrtohet së paku gjatë çdo tre mujori, për këtë Këshilli do të jap konkluzione dhe propozim masa, për përmirësimin e tyre.

Koha e realizimit: Gjatë tërë vitit shkollorë.

2. Sigurimi i shkollës dhe nxënëseve

Këshilli i prindërve do të kujdeset për sigurimin e shkollës dhe mbrojtjen e saj në bashkëpunim me Drejtorin, Këshillin e prindërve dhe Këshillin e shkollës.

Koha e realizimit: Gjatë tërë vitit shkollorë.

3. Aktivitete nga jeta kulturore argëtuese e nxënësve

Këshilli i prindërve do të orvatet që të vazhdoj me përgatitjen e gazetës shkollore, në përpilimin e së cilës marrin pjesë nxënësit e të gjitha viteve në bashkëpunim me profesorët dhe drejtorin e shkollës. Këshilli propozon që të organizohen vizita e evenimenteve kulturore,garave sportive, koncerteve humanitare etj.

Këshilli i prindërve do të marrë pjesë në tubimin e mjeteve me qëllim të mundësimit të punës më intensive të seksionit dramatik, letrarë, korit të shkollës, organizimit të garave sportive në nivel të shkollës etj.

Koha e realizimit: Gjatë tërë vitit shkollorë.

4. Përkrahja financiare dhe donacionet

Këshilli i prindërve në mënyrë aktive do të marrë pjesë në tubimin e ndihmës financiare me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës në shkollë. Do të marrë pjesë në organizimin dhe realizimin e ekskursioneve shkencore – arsimore për nxënësit dhe arsimtarët.

Koha e realizimit: Gjatë tërë vitit shkollorë.

5. Bashkëpunimet dhe aktivitetet tjera

Këshilli i prindërve në mënyrë aktive do të marrë pjesë në bashkëpunimin me Këshillin e prindërve të shkollave të tjera të mesme në nivel të komunës, qytetit dhe Republikës.

Këshilli do të bashkëpunojmë me disa institucione shtetërore, firma private, organizata civile, ambasada të huaja me qëllim të realizimit të suksesshëm të planeve dhe programeve mësimore, përkatësisht përmirësimit të klimës punuese si për nxënësit ashtu edhe për personelin edukativo arsimorë.

Koha e realizimit: Gjatë tërë vitit shkollorë.

Komunikimi me opinionin dhe promovimi i shkollës

Bashkësia lokale

Bashkëpunimi me partnerët social realizohet përmes ndihmës së ndërsjelltë profesionale, me pajisje gjatë realizimit të projekteve të vogla shkollore, shfrytëzimin e mjeteve demonstruese dhe veglave, pranimi i nxënësve gjatë realizimit të ekskursioneve të planifikuara profesionale, vizitave, me ndërmarrjet, institucionet sociale, institucionet e administratës publike. Do të realizojmë bashkëpunim me organizatat, kompanitë dhe Qytetin e Tetovës. Nxënësit do të inkuadrohen në të gjitha manifestimet që i organizon Komuna e Tetovës.

Shkolla ka nënshkruar Memorandumi për bashkëpunim me Komunën e Tetovës me të cilin do të implementohet bashkëpunimi për realizim të programit ekologjik.

Institucione nga fusha e kulturës

Shkolla do të implementoj komunikim me institucionet nga fusha e kulturës: biblioteka, muze, teatro, kinema etj. Nxënësit do të marrin pjesë në konkurse letrare, do të realizohen vizita të monumenteve kulturore historike, muzeumeve, ekspozitave etj.

Institucionet nga fusha e arsimit

Në bashkëpunim me shkollat tjera edhe këtë vit, planifikojmë që të vazhdojmë me bashkëpunimin e deritanishëm me shkollat e mesme në qytet dhe në fakultetet e qytetit.

Vizita e nxënësve në disa prej shkollave me shkëmbim ose gjatë realizimit të ekskursioneve profesionale është aktivitet i planifikuar që deri më tani është realizuar.

Bashkëpunimi i aktiviteteve sportive dhe garave në nivel komunal, rajonal dhe republikan, gjithashtu është një aktivitet i planifikuar për bashkëpunim me shkollat tjera të Republikës.

Ndihma që na nevojitet gjatë përsosjes profesionale, planifikojmë që ta kërkojmë në katedrën e pedagogjisë pranë Fakultetit të filozofisë në Universitetin e Tetovës, me të cilin edhe deri më tani kemi bashkëpunuar, si dhe ndihma profesionale nga bashkëpunëtorët profesionalë, këshilltarët e pavarur pranë BZHA dhe Qendra për arsim të mesëm profesional. Për të gjithë vështirësitë, paqartësitë dhe shqyrtimet, propozimet dhe mendimet, pjesëmarrja në përpilimin e planave dhe programeve mësimorë realizohet bashkëpunimi që edhe deri më tani kemi realizuar dhe planifikuar, edhe këtë vit planifikojmë që të realizojmë këto bashkëpunime me këtë do të kontribuojmë për kultivimin e traditës dhe zhvillimin e programeve të reja mësimore.

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

Organizatat joqeveritare

Shkolla do të bashkëpunojmë me organizatat joqeveritare për realizim të projekteve të lejuar nga Komuna e Tetovës.

Projektet në fushën e arsimit janë të grupuar sipas këtyre prioriteteve:

- Avancimi i të drejtave të nxënësve në suaza të sistemit të shkollave të mesme
- Avancimi i shëndetit dhe ambientit jetësorë
- Edukimi dhe trajnimi i shkollarëve të mesëm për avancim të aftësive dhe diturive nga fusha e oratorisë, sipërmarrësisë, marketingut dhe inovacioneve
- Organizimi i manifestimeve, evenimenteve kulturore artistike dhe para për shkollarët e viteve përfundimtare, promovim të maturantëve më të mirë nga shkollat e mesme të Komunës së Tetovës.
- Organizimi i manifestimit përkatës për promovim të maturantëve më të mirë nga shkollat e mesme të qytetit
- Organizimi i forumeve, punëtorive, garave dhe manifestimeve për pasurim të programeve të aktiviteteve jashtë mësimore dhe avancimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën shkollore.

Shoqatat sportive

Shkolla të krijoj bashkëpunim me shoqatat sportive: klubi i futbollit "Shkëndija" dhe KV "Shkëndija".

Organizatat shëndetësore

Me qëllim të përkujdesjes për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, shkolla do të bashkëpunojë me Shtëpinë e shëndetit – Dispanzerit shkollorë, Institutin për shëndet publik,OK e Kryqit të Kuq, Fondin për shëndetësi,

Kompanitë e sigurimit të nxënësve.

Në bashkëpunim me Institutin për shëndet publik, do të organizohen ligjërata edukative nga fusha e raporteve humane mes gjinive, me organizata civile nga fusha e parandalimit të shfrytëzimit të mjeteve narkotike.

Mediumet

Të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet, shkolla do ti promovojë në bashkëpunim me shtypin ditor dhe me stacionet televizive. Me qëllim të promovimit të shkollëspërmes mediumeve të shkruara dhe elektronike do të informohet opinioni për të gjitha aktivitetet lidhur me realizimin e programit për integrim të edukimit ekologjik në sistemin arsimorë të Maqedonisë së Veriut.

Në korridorin e shkollës do të vendoset eko panel përmes cilit do të njoftohen nxënësit, arsimtarët, punonjësit tjerë, prindërit dhe gjithë ata që do të vizitojnë shkollën.

Në web faqen e shkollës do të shpallen të gjitha aktivitetet lidhur me këtë projekt.
Arsimtari përgjegjës për promovim të shkollës është anëtarë i eko këshillit Musa Ceka dhe përfaqësuesi i prindërve në eko këshillin Lazim Kamberi.

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E DREJTORIT

Realizimi i misionit të shkollës është i mundshëm nëse krijohen dhe zhvillohen mekanizma të caktuar, me të cilat do ti jepet vendi i cili i takon në shoqëri. Për ajo të ndodh, përskaj faktorëve tjerë, nevoja për planifikim kualitativ e udhëheqjes së drejtorit imponohet në mënyrë të pashmangshme.

Programi vjetor i udhëheqjes të planifikuar të drejtorit të shkollës i përmban këto komponentë:

1.OBJEKTI-LËNDA E PLANIFIKIMIT

a.Aktivitetet e planifikuara paraqesin drejtimin e aktiviteteve të drejtorit gjatë vitit shkollor

2.PERIUDHA E PLANIFIKIMIT

a.Shtator 2025 deri më Gusht 2026

3.QËLLIMI I PLANIFIKIMIT

4.Për të arritur objektivat e përcaktuara në Programin Vjetor të Punës në lidhje me vitin shkollor aktivitetet e planifikuara të shkollës përfaqësojnë një nga elemente shumë të rëndësishme.

5.Qëllimi kryesor i këtij plani është Planifikimi për menaxhimin dhe koordinimin për të arritur qëllimet

6.PROGRAMIMI FUNKSIONAL

Fusha e punës	**Koha e realizimit**
Formimi i klasave dhe përgatitja e planit të orëve sipas detyrave aktive. Pjesëmarrja në përgatitjen vjetore të programit të punës / dhe koordinimin e punës në grupe	Qershor-Shtator
Monitorimi i zbatimi i programit të punës vjetore të vitit shkollor dhe të programeve të planifikuara për mësuesit.	Shtator- Gusht
Konsultimi dhe këshillimi për punë për arsimtarët dhe bashkëpunëtorët	Shtator- Gusht
Ndihmë dhe koordinim me kryetarët e aktiveve profesionale në realizimin e aktiviteteve të planifikuara.	Shtator- Gusht
Këshillit drejtues të mësimdhënies, aktiviteteve të planifikuara më parë	Shtator- Gusht
Rol këshillëdhënës në punën e organeve profesionale në shkollë.	Shtator- Gusht
Bashkëpunimi me institucionet shoqërore profesionale jashtë shkollës	Shtator- Gusht

7.ORGANIZIMI

Përmbajtjae punës	**Realizimi**
Formimi i një ekipi për përgatitjen e programit të punës vjetore të shkollës. -Krijimi i një ekipi për të monitoruar zbatimine programit vjetor të punës. -Krijimi i një ekipi planifikimit të zhvillimit.	Maj - Qershor
-Vëzhgimi profesional gjatë organizimit dhe realizimit të lëndëve profesionale, shtuese dhe mësim plotësuese,	Shtator- Qershor
-Vëzhgimi dhe dhënia e ndihmës profesionale gjatë organizimit dhe realizimit të aktiviteteve projektuese	Shtator- Qershor

-Vëzhgimi në planifikimet e arsimtarëve. Analiza e kualitetit në përpunimin e planeve vjetore, tematike dhe ditore.	Shtator- Gusht
-Vëzhgimi dhe zbulimi i anomalive në suksesin e nxënësve në bashkëpunim me kujdestarët e paraleles për zbulimin e arsyeve të sjelljeve të pahijshme të nxënësve: - Bisedë individuale me nxënës. - Bisedë me arsimtar dhe prind	Shtator- Gusht
-Dhënia e obligimi për përpunimin e analizave statistikore të të dhënave për suksesin, rregullshmërinë dhe sjellja e nxënësve për çdo periudhë të klasifikuar.	Shtator- Gusht
- Organizimi i një vizite të planifikuar në klasa te mësues, të cilët treguan rezultate të dobëta në punën e, konsultim dhe bisedim për përmirësimin e gjendjes në mësim	Shtator- Gusht
-Formimi i një ekipi për ndihmë dhe bashkëpunim për realizimin e garave shkollore dhe komunale	Shtator- Gusht
-Organizimi i aktiviteteve në shkollë për partronatine shkollës dhe datave të tjera jubilare.	Shtator- Gusht

8.UDHËHEQJA

Përmbajtjae punës	**Koha e realizimit**
-Studimi, parashikimi dhe analizimi i kushteve të punës në shkollë	Shtator- Gusht
-Planifikimi i punës dhe menaxhimin e këshillit të mësimdhënies	Shtator- Gusht
-Ndihma e mësimdhënësve, kujdestarëve të klasës në punën edukativo-arsimore gjatë planifikimi -Zgjedhja dhe aprovimi i formave dhe metodave të reja të punës	Shtator- Gusht
Punë këshillëdhënëse me arsimtarët gjatë përgatitjes së planeve operative ditore për realizimin e orëve më simore.	Shtator- Qershor
-Pjesëmarrja në punën e bordit të shkollës	Shtator- Gusht
-Punë këshillëdhënëse me kujdestarët e klasës në lidhje me: *Kryesinë e klasës *Sjellja e nxënësve *Suksesi dhe rregullshmëria	Shtator- Gusht
-Planifikimi i aktiviteteve gjatë punës me këshillin e prindërve	Shtator- Gusht
-Koordinimi në bashkëpunim me shërbimet profesionale në realizimin dhe bashkëpunimin të relacionit familje-shkollë	Shtator- Gusht
-Planifikimin e aktiviteteve gjatë shqyrtimit të situatave konfliktuoze.	Shtator- Qershor
-Vendosja e arsimtarëve fillestar në veprimtarinë edukativo – arsimore	Shtator- Tetor

9. PUNA NORMATIVE

-Planifikimin e aktiviteteve në përgatitjen e akteve normative dhe ndihmën e shërbimeve profesionale në përgatitjen e tyre.

-Udhëheqjen e situatës

10. TRAJNIMI I PERSONELIT DHE TRAJNIMI PERSONAL

11. BASHKËPUNIM ME ORGANET DHE TRUPAT PROFESIONALE NË SHKOLLË DHE MË GJËRË

12. STËRVITJE

Përmbajtjae punës	Koha e realizimit
-Ndihmë profesionale për arsimtarët fillestar	Shtator- Gusht
-Aktivitete konsultative për ndjekjen dhe notimin e arsimtarëve: *instrumente në vëzhgim, *notim dhe kontrollim	Shtator- Gusht
-Ndihmë profesionale gjatë përgatitjes së raportit, analizë, kontrollimi i punës nëshkollë	Shtator- Gusht
Adaptimi dhe vëzhgimi i nxënësve të vitit të parë –bisedime individuale dhe në grupe, anketim pyetësor, bisedime me prindërit, arsimtarët	Shtator- Dhjetor
Orientim profesional me nxënësittë vitit të katërt – parashikim i qëllimeve dhe interesave të nxënësve nëpërmjet anketave dhe bisedimeve.	Prill-Maj

1.EVALUIMI DHE HULUMTIMI NË PUNË

Përmbajtjae punës	Kohae realizimit
-Analiza dhe aktivitete hulumtuese për: * mungesa nga mësimi * arsyeja për suksesin e dobët të nxënësve	Shtator- Qershor
-Përcaktimi i detyrave përpërgatitjen të instrumenteve për aktivitete hulumtuese (pyetësor, lista anketuese etj))	Shtator- Qershor
-Pjesëmarrja në seminare, këshilla, punëtori etj.	Shtator- Gusht
-Analiza e suksesit të nxënësve të viteve të treta në krahasim me suksesin e viteve të dyta.	Qershor-Gusht
-Pjesëmarrja dhe organizimi i formave dhe i zhvillimit profesional – aktiveve, seksioneve, seminare interne	Shtator- Gusht
-Vëzhgimi i literaturës profesionale.	Shtator- Gusht

Plani aksional për operacionalizimin e të dhënave të aktiviteteve dhe sferës paraqet dokument të posaçëm i cili nuk paraqet pjesë të programit vjetor.

Prof. Jeton Kamberi

Drejtor

ShMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"– Tetovë
Rr. „Braqa Milladinovi ", nr. 134. 1200 Tetovë
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

СОУГ "Кирил Пејчиновиќ"– Тетово
Ул.„Браќа Миладинови ",бр. 134 ; 1200 Тетово
e-mail: sougimnazija-kirilpejchinovikj-tetovo@schools.mk
Web: www.kp.edu.mk

PROGRAMI PËR PUNËN E NDIHMËS DREJTORIT

Viti shkollor 2026/2027

Aktivitetet	Korniza kohore	Qëllimet
Përgatitja për mbledhjen e parë të aktiveve, mjetet e nevojshme dhe kontratës së punës; • Kontrollimi pedagogjik i administrimit për vitin e kaluar shkollor; • Ndërhyrje në punën të mësimdhënësve të sapo punësuar; • Përgatitja e planit për kujdestari; • Klasifikimi i aktiviteteve projektuese; • Kontrollimi i planeve dhe përgatitjeve globale dhe tematike të ofruara të arsimtarëve; • Përpilimi i listës së nxënësve për marrjene teksteve shkollore; • Përpilimi i listave të nxënësve për biletat mujore; • Përgatitja e raportit mujor të punës;	shtator	•Fillim i suksesshëm i vitit shkollor, •Furnizimi i pajisjeve të nevojshme •Bashkëpunimi i suksesshëm me aktivet •Përfshirja e suksesshme e stafit të ri mësimor •Ndihmë për nxënësite shtresave të rrezikuara sociale
▪ Puna instruktive pedagogjike me arsimtarët fillestar; ▪ Përgatitja e planit të aktiviteteve projektuese; ▪ Shqyrtimi dhe analiza e përgatitjeve për punë; ▪ Vizitat në orë; ▪ Mbledhjet e aktiveve; ▪ Prania në takimet e para të prindërve, ▪ Takim me kryetarët e klasave, ▪ Orari për provimet e çrregullta; ▪ Përgatitja e raportit mujor të punës;	tetor	▪ Të ndihmohen kolegët e rinj, që me sukses të përshtaten në punë ▪ Të informohen prindërit në lidhje me mundësitë që ofron shkolla ▪ Zgjidhja e problemeve dhe përmirësimi i klimës për punë.
▪ Këshillat e paraleleve për tremujorine parë; ▪ Takimi me aktivet, analiza e suksesit dhe disiplinës; ▪ Vizitat në orët mësimore ▪ Planifikimi i mësimit plotësues për nxënësit të cilët kanë treguar më pak sukses; ▪ Orari për provimet e çrregullta; ▪ Ndarja e teksteve shkollore për nxënësit që marrin ndihmë sociale; ▪ Përgatitja e raportit mujor të punës	nëntor	▪ Analizae suksesit dhe disiplinës në periudhën ekaluar ▪ Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara ▪ Gjetjae mënyrave për tu përfshirë shkolla në aktivitetet e qytetit. ▪ Realizimi i suksesshëm i procesit edukativo arsimor ▪ Përmirësimi i suksesit të nxënësve

▪ Përgatitja e kështillave të klasave që përcaktojnë suksesin dhe sjelljen e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë; ▪ Rishikimi i të rë dokumentacionit pedagogjik në bashkëpunim me shërbimin pedagogjik-psikologjik; ▪ Vizita në orët mësimore ▪ Takim me kryetarët e klasave, ▪ Pjesëmarrja në përgatitjen e orarit; ▪ Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të realizuara në shkollë, ▪ Përgatitja e raportit mujor të punës	dhjetor	▪ Analiza e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë, ▪ Zbatimi i suksesshëm i projekteve, Zgjidhja e problemeve dhe përmirësimi i klimës për punë.
▪Orari për provimet përfundimtare; ▪Mbledhje me aktivet; ▪Rishikimi i tërë dokumentacionit pedagogjik në bashkëpunim me shërbimin pedagogjik-psikologjik , ▪Rishikimi i ditarëve të punës ▪Analizë të situatës me numrin e orëve të mbajtura dhe marrja e masave për të plotësuar orët e humbura;	janar	▪ Analizae rregullshmërisë dhe suksesit të nxënësve ▪ Përfundimi i suksesshëm i procesit edukativo arsimor
*Aktivitetet me shërbimin pedagogjik- psikologjik për analizën e suksesit dhe planifikimit të aktiviteteve për përmirësim dhe aktiviteteve të tjera në shkollë *Formimi i kështillit për të festuar maturën; *Aktivitetet për të informuar nxënësit për programet zgjedhore të A dhe B, para regjistrimit nga vitii dytë për vitin e tretë. *Informim për provimin përfundimtar, ose të maturës shtetërore *Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të zbatuara në shkollë, *Vizita në orët mësimore; *Takim me kryetarët e klasave, *Orari për provimet e çrregullta; *Përgatitja e raportit mujor të punës	shkurt	▪ Analiza e realizimit të aktiviteteve të planifikuara ▪ Përmirësimi i suksesit dhe sjelljes ▪ Zgjedhja e problemeve dhe përmirësimi i klimës për punë. ▪ Informim në kohë të nxënësve
Përgatitja për mirëmbajtje të kështillave të paraleleve në klasat përfundimtare, monitorimin e gjendjes së vlerësimit; Vizita në orët mësimore; Mbledhje me aktivet për aktivitetet në lidhje me provimet e maturës shtetërore dhe shkollore Orari për provimet e çrregullta; Përgatitjen për kështillatë e paraleleve në klasat jo përfundimtare Kontrollimi i realizimit të programit mësimor, Caktimi i kështillit dhe komisionit për maturë shtetërore. Përgatitja e raportit mujor të punës	mars	Vëzhgimet e kështillave për zbatimin e mësimit të rregullt, shtesë dhe plotësues, Njoftimi i detajuar i nxënësve me mënyrën e marrjes së provimit të maturës shtetërore dhe shkollore.

▪ Përgatitja për mirëmbajtje të kështillave të paraleleve në klasat jopërfundimtare ▪ Përcjellja e gjendjes së vlerësimit ▪ Mbledhje me aktivet për aktivitetet në lidhje me provimet e maturës shtetërore dhe shkollore ▪ Orari për provimet e çrregullta; ▪ Takim me kryetarët eklasave ▪ Orari për provimet klasore dhe provimeve përfundimtare ▪ Oraripër prezantimin e detyrave projektuese për klasat përfundimtare ▪ Përgatitja e raportit mujor të punës	prill	▪ Vëzhgimet nga këshilli i paraleleve për zbatimin e mësimit të rregullt, shtesë dhe plotësues ▪ Zgjedhjae problemeve si dhe përmirësimi i klimës për punë. ▪ Paraqitja dhe prezantimi i suksesshëm i detyrave projektuese të maturës
▪ Këshilla e paraleleve në klasat përfundimtare; ▪ Orari dhe përgatitjet për riprovimet dhe provimeve përfundimtare; ▪ Aktivitetet me këshillin për të festuar maturën; ▪ Orari i vizitave në orët mësimore ▪ Përgatitja për zhvillimin e procesit gjatë vitit shkollor në fazën përfundimtare; ▪ Orari për provimet e çrregullta; ▪ Përgatitja e Këshillave për klasat përfundimtare; ▪ Rishikimi i tërë dokumentacionin pedagogjik; ▪ Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve që realizohen në shkollë	maj	▪ Analiza e suksesit të nxënësve ▪ Të përgatiten nxënësit për riprovimet dhe maturën ▪ Realizimivi suksesshëm i projekteve dhe detyrave projektuese nga aktivitetet e projekteve ▪ Festimi i suksesshëm i mbrëmjes së maturës Zgjidhja e problemeve dhe përmirësimi i klimës për punë
▪Këshillat e paraleleve për fund të vitit shkollor; ▪Orar për riprovimet ▪Organizimi i provimeve përfundimtare; ▪Planifikimi i mësimit plotësues për nxënësit të cilët janë të udhëzuar në riprovime ; ▪Mbledhjeme aktivet për shpërndarjen orientuese të orëve për vitin 2026/2027. ▪Mbarimi i aktiviteteve aktuale; ▪Përgatitja e Këshillave të paraleleve për ta përfunduar vitin shkollor; ▪Vlerësimi vjetor i projekteve të realizuara në shkollë; ▪Përgatitja e raportit të punës vjetore	qershor	▪ Analizë të rezultateve nga mësimi për vitin e kaluar ▪ Vëzhgimi për funksionimin e përgjithshëm dhe zbatimin e programit vjetor të punës ▪ Zbatimi i suksesshëm i projekteve
